



DISCOVER
— ITS BEAUTY —

Pjesa 2

FEJA E
ADEMIT DHE E HAVASË

DR. NAXHI IBRAHIM



FEJA E ADEMIT DHE E HAVASË

NJË FE DHE NJË MESAZH!

Që nga krijimi i Ademit dhe i Havasë përgjatë historisë vetëm një besim i vërtetë me një mesazh origjinal i është përcjellë në vazhdimësi njerëzimit. Për t'i përkujtuar njerëzit, që të besojnë në Allahun dhe ta adhurojnë vetëm Atë, dhe për t'i kthyer ata prapë në rrugë e drejtë, shumë Profetë dhe të Dërguar - duke përfshirë Ademin, Nuhun, Ibrahimin, Musain, Isain dhe Muhamedin - janë dërguar nga Zoti i vetëm i vërtetë Allahu, Krijuesi, për të përcjellë mesazhin origjinal:

ZOTI JUAJ I VËRTETË ËSHTË ALLAHU. ADHUROJENI VETËM ATË.

Këta Profetë dhe të Dërguar, të gjithë kanë predikuar të njëjtin mesazh, prandaj feja e tyre, po ashtu duhet të jetë e njëjtë! Nënshtrimi ndaj vullnetit të Zotit është në thelb të mesazhit të tyre. Kjo fjalë, **'NËNSHTRIM'**, është kuptimi i fjalës në gjuhën arabe **'ISLAM'**.

Kurani pohon se nënshtrimi ndaj Zotit, ose 'Islami', është feja e vërtetë e Ademit, dhe e të gjithë Profetëve dhe të Dërguarve të Zotit. Bibla përmend shumë thënie, përmes të cilave Jezusi i mëson ndjekësit e tij, t'i nënshtrohen vullnetit të Zotit dhe t'i zbatojnë urdhrat e Tij. Njëjtë, Bibla shpall këto fjalë të vëllait të Jezusit, Jakobit, i cili gjithashtu i referohet kuptimit të Islamit (nënshtrimit ndaj Zotit) kur thotë: ***"Nënshtrojeni, pra, Perëndisë, kundërshtoni djallin dhe ai do të largohet nga ju!"***. (Jakobi, 4:7)

Fjala 'musliman' domethënë një person, i cili i nënshtrohet vullnetit të një Zoti të vërtetë, prandaj muslimanët janë ndjekësit e vërtetë të Ademit, Nuhut, Ibrahimit, Musait, Jezusit, Muhamedit dhe të Profetëve të tjerë.



ZOTI I VETËM I VËRTETË NË TESTAMENTIN E VJETËR TË BIBLËS

- ***“Dëgjo, Izrael, Zoti, Perëndia ynë, është një i vetëm.”*** (Ligji i përtërirë, 6:4)
- ***“...sepse Unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër; jam Perëndia dhe askush nuk më ngjet Mua.”*** (Isaia, 46:9)
- ***“Për këtë je i Madh, o Zot, o Perëndi. Asnjeri nuk është si Ti dhe nuk ka tjetër Perëndi veç Teje, me sa kemi dëgjuar me veshët tona.”*** (2 i Samuelit, 7:22)
- ***“... me qëllim që ju të më njihni dhe të keni besim tek Unë, si dhe të merrni vesh që Unë jam Ai. Para meje ...? dhe pas Meje nuk do të ketë asnjë tjetër. Unë, Unë jam Zoti, dhe përveç Meje nuk ka Shpëtimtar tjetër.”*** (Isaia, 43:10-11)
- ***“O Zot, askush nuk është i ngjashëm me Ty dhe nuk ka tjetër Perëndi veç Teje, sipas tërë ato që kemi dëgjuar me veshët tona.”*** (1 i Kronikave, 17:20)
- ***“...Unë jam i Pari dhe jam i Fundit, dhe përveç Meje nuk ka Perëndi.”*** (Isaia, 44:6)
- ***“...Nuk ka Perëndi tjetër veç Meje, një Perëndi i Drejtë, një Shpëtimtar; nuk ka asnjë veç Meje. Kthehuni nga Unë dhe do të shpëtoni, ju të gjithë njerëzit anembanë botës. Sepse Unë jam Perëndia dhe ka asnjë tjetër. Premtimi Im është i vërtetë, dhe nuk do të ndryshojë. Unë solemnisht premtoj në gjithë atë që jam; Çdokush do të vijë tek Unë, dhe do të përkulet para Meje.”*** (Isaia, 45:21-23)



PSALM 27

★ In the day of my trouble I will say, "O God, why have you forsaken me? why are you so far from me? why have you hidden your face from my face?" O God, do not be angry with me, as you have been angry with me in the day of my wrath. O God, do not be angry with me, as you have been angry with me in the day of my wrath. O God, do not be angry with me, as you have been angry with me in the day of my wrath.

ZOTI I VETËM I VËRTETË NË TESTAMENTIN E RI TË BIBLËS

- ***“Dhe ja, iu afrua dikush dhe i tha: ‘‘Mësues i mirë, çfarë të mirë duhet të bëj që të kem jetë të përjetshme?. Dhe ai tha: Pse më quan të mirë? Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmi: Perëndia. (Mateu, 19:16-17)***
- ***“Dhe jeta e përjetshme nënkupton të të njohim Ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar.” (Gjoni, 17:3)***
- ***“...Adhuro Zotin, Perëndinë tënd, dhe shërbeji vetëm Atij.” (Mateu, 4:10)***
- ***“Dhe Jezusi u përgjigj: Urdhërimi i parë i të gjithëve është: «Dëgjo, o Izrael: Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot», dhe: «Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!». Ky është i pari urdhërim. Dhe i dyti i ngjan këtij: «Duaje të afërmin tënd porsì vetveten». Nuk ka urdhërim tjetër më të madh se këta.” (Marku, 12:29-31)***
- ***“Atëherë skribi i tha: Mirë, Mësues. E ke thënë të vërtetën:, se ka vetëm një Perëndi dhe s'ka asnjë tjetër përveç Tij.” (Marku, 12:32)***
- ***“Jezusi atëherë iu përgjigj atyre dhe tha: Doktrina ime nuk është imja, por e Atij që më ka dërguar.” (Gjoni, 7:16)***



ZOTI I VETËM I VËRTETË NË KURAN

- ***“Zoti juaj është një Zot i vetëm! S’ka zot tjetër (të denjë për adhurim), përveç Atij, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!”*** (Kur’ani, 2:163)
- ***“Thuaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! 2. Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. 3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. 4. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!’.”*** (Kur’ani, 112: 1-4)
- ***“...S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!”.*** (Kur’ani, 21:25)
- ***“Ky është Allahu, Zoti juaj. S’ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij, Krijuesit të çdo gjëje, andaj adhuroni vetëm Atë! Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje!”*** (Kur’ani, 6:102)
- ***“Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër? I Lartësuar qoftë Allahu dhe i Lavdëruar mbi çdo gjë që ia shoqërojnë (në adhurim).”*** (Kur’ani, 27:63)
- ***“...Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër? Thuaj (o Muhamed): ‘Sillni provat tuaja, nëse ajo që thoni është e vërtetë!’.”*** (Kur’ani, 27:64)
- ***“Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përrjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai, për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë, që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u i Tij, shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!”*** (Kur’ani, 2:255)



EMRAT DHE TERMAT BAZIKË ISLAMË

Allah: Në gjuhën arabe emri Allah është emri kryesor i Zotit të vërtetë, Krijuesit. Këta janë vetëm disa nga emrat dhe cilësitë e Allahut: Zoti, i Gjithëmëshirshmi, Mëshiruesi, i Gjithëpushtetshmi, Gjykuesi, i Gjithëdijshmi, Gjithëshikuesi, Gjithëdëgjuesi, i Madhi, Falësi, më i Larti.

Muhamedi,: paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ka lindur në Mekë, në vitin 570. Ai u bë i njohur tek njerëzit e tij, me emrin 'i Besueshmi' (Besniku). Ai është Profeti i fundit i Zotit të Vetëm të Vërtetë, i Cili e dërgoi atë tek të gjithë njerëzit, që t'i urdhërojnë ata ta adhurojnë vetëm Allahun, Krijuesin.

Kurani i Madhërishëm: Është fjala e fundit e Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), siç i është shpallur Profetit Muhamed. Kur'ani është kushtetutë e shpallur, për të rregulluar dhe udhëhequr jetën tonë njerëzore.

Islami: Nënkupton nënshtrim ndaj vullnetit të Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), Krijuesit. Islami na mëson se rruga drejt jetës së lumtur, të kënaqshme dhe të përhershme është duke besuar në Allahun dhe në Profetin e Tij të fundit, Muhamedin a.s., dhe duke shqiptuar shahadetin: "Dëshmoj se nuk ka të adhurar tjetër që meriton të adhurohet pos Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut."

Myslimani: Ai që i nënshtrohet vullnetit të Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), Krijuesit. Myslimanët besojnë në Allahun dhe bëjnë vepra të mira. Ata i binden urdhëresave të Muhamedit a.s, Isait a.s, dhe të gjithë profetëve të tjerë (paqja e Zotit qoftë mbi ta), sikurse është besimi në Një Zot të Vërtetë, lutja, përlutja dhe gjuhëzimi në adhurim.

Xhamia: (mesxhidi) është një vend i pastër i përlutjes, që përdoret nga myslimanët për lutje dhe adhurim. Për më tepër, xhamia është një vend i qetë dhe paqësor dedikuar përmendjes së Allahut (Zotit), lutjes ndaj Tij dhe leximit të Kuranit të Madhërishëm.



Haramain Mosque
Masjid al-Haram
المسجد الحرام
Haramain Mosque
المسجد الحرام

Përfundim

Të gjithë Profetët dhe të Dërguarit e Zotit, duke përfshirë Ademin, Nuhun, Ibrahimin, Musain, Isain dhe Muhamedin janë dërguar nga Zoti i njëjtë, Allahu, Krijuesi, për ta përcjellë mesazhin e njëjtë tek të gjithë njerëzit:

ZOTI I VËRTETË, ALLAHU ËSHTË NJË. ADHUROJENI VETËM ATË.

Meqenëse të gjithë këta Profetë dhe të Dërguar predikuan mesazhin e njëjtë, atëherë, feja e tyre, po ashtu duhet të jetë e njëjta! Nënshtrimi ndaj Vullnetit të Zotit është thelbi i mesazhit të tyre. Fjala 'NËNSHTRIM' është kuptimi i fjalës arabe 'ISLAM'.

Kurani pohon se 'Islami' është feja e vërtetë e Ademit dhe e Havasë, dhe e pasardhësve të tyre deri në Ditën e Gjykimit.

Përfundimisht, për të arritur shpëtimin, ne duhet të besojmë në mesazhin e mësipërm, me vullnet dhe me zemër.

Por kjo nuk mjafton! Ne duhet, po ashtu të besojmë në Profetët e Zotit të Vërtetë (duke përfshirë Muhamedin a.s.) dhe ta ndjekim fenë, udhëzimin dhe mësimet e tij.

Kjo është rruga, për një jetë të lumtur deri në përjetësi!

A JENI ENDE KURESHTAR?

Nëse jeni kureshtar dhe të interesuar të zbuloni më shumë informacione dhe detaje rreth Islamit, ju lutem vizitoni faqen tonë:

www.discoveritsbeauty.com

Keni mirësinë të na dërgoni me e-mail pyetjet dhe kritikën tuaj:

info@discoveritsbeauty.com

SERITË E 'ZBULOJENI BUKURINË E TIJ'

- 1) Vetëm maja e ajsbergut
- 2) Feja e Ademit dhe Havasë
- 3) ABC-ja e Islamit
- 4) Përgjigje ndaj pyetjeve madhore të njerëzimit
- 5) Emrat e Tij të bukur
- 6) Shpallja e fundit
- 7) I Dërguari i fundit

WEBFAQET E DOBISHME ISLAME

<http://www.allahsquran.com>

<http://www.quranexplorer.com>

<http://www.islamhouse.com>

<http://www.edialogue.com>

<http://www.islamreligion.com>

<http://www.newmuslimguide.com>

<https://aboutislam.chat>

<https://guidetoislam.com>

DËSHMIA E BESIMIT HYRJA NË ISLAM

Dëshmoj se nuk ka tjetër të adhurar me meritë përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.”

Në arabisht lexohet:



që në shqip tingëllon sikurse më poshtë:

**ESH-HEDU EN LA ILAHE IL-LA ALLAH,
UE ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDEN RESULULLAH!**



Kjo është dëshmia e besimit, që duhet të deklarojmë në mënyrë që të përqafojmë Islamin; ajo përmbledh të vërtetën, bukurinë dhe thjeshtësinë e Islamit.



DISCOVER —ITS BEAUTY—

WWW.DISCOVERITSBEAUTY.COM



Scan it!

GLOBAL ACADEMY FOR TRANSLATION AND EDUCATION (GATE)
LONDON | THE UNITED KINGDOM

كتاب دين آدم وحواء باللغة الألبانية